



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1585 Prot.

Tiranë, më datë 15.11 .2021

VENDIM
Nr. 637, datë 12.11.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.11.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Restaurimi dhe Punime mirëmbajtëse “Komiteti i Kosovës”, Shkodër”, monument kulture i kategorisë së I-rë, me aplikues z. Edmir Abdija, projektues restaurator znj. Shpresa Prifti dhe zhvillues “Star Plus” sh.p.k.;
 2. Në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2:
 - Zbatimi i punimeve duhet të kryhet nga subjekte të licencuara për këtë kategori në restaurim;
 - Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të kryhet nga subjekte të licencuara për mbikëqyrje dhe kolaudim për këtë kategori në restaurim;
 3. DRTK Shkodër të kryejë kontrollin teknik gjatë zbatimit të punimeve dhe të raportoje periodikisht pranë Sekretarisë Teknike të IKTK-së;
 4. Subjekti duhet të dorëzojë 2 (dy) kopje fizike të nënshkuara elektronikisht të dokumentacionit tekniko-ligjor pranë Sekretarisë Teknike në IKTK;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
 7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

